



Raport i Zyrës Civile Ndërkombëtare

27 shkurt 2009

Vjenë, Austri

Raport i Zyrës Civile Ndërkombëtare

27 shkurt 2009

- I. Hyrje
- II. Përbushja e zotimeve – progresi i Kosovës në zbatimin e PGJS-së
- III. Rrjeti në rritje i marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës
- IV. Viti vijues

Raport i Zyrës Civile Ndërkombëtare

27 shkurt 2009

I. HYRJE

Muaji shkurt i vitit 2009 shënon disa momente të rëndësishme për Republikën e Kosovës dhe partnerët e saj ndërkombëtarë. Vetëm para disa ditësh, Kosova e përmbylli vitin e parë si shtet i pavarur dhe sovran, përderisa 27 shkurti shënon edhe përmbylljen e vitit të parë të mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICR). Gjatë vitit të kaluar ishim dëshmitarë të një progresi të madh në Kosovë: progres në ndërtimin e institucioneve, në ankorimin e sundimit të ligjit, në krijimin dhe konsolidimin e elementeve të shtetësisë, si dhe në zënien e vendit të saj në bashkësinë e kombeve si një demokraci shumetnike. Me anë të të gjitha veprimeve të veta, shteti i Kosovës e ka dëshmuar pavarësinë e tij dhe ka treguar se pavarësia është e pakthyeshme. Po ashtu, Kosova në partneritet me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO) ka bërë hapa të mëdhenj drejt përmbushjes së premtimeve që i kishte bërë qytetarëve të saj dhe botës kur ajo u zotua në Deklaratën e Pavarësisë së saj, se do të bëjë zbatimin e plotë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PGJS).

ICR-ja me sukses e mori përsipër rolin të cilin ia ngarkon PGJS-ja, rol i cili gjendet edhe në Kushtetutën e Kosovës. Ne kemi krijuar lidhje të forta me një numër të madh udhëheqësish të Kosovës, si në kryeqytet ashtu edhe nëpër komuna. Për ta mbikëqyrur dhe mbështetur zbatimin e PGJS-së, ne punojmë ngushtë me ta, ndërkohë që ata i përgatisin vendimet. Gjithmonë mbizotëron fryma e bashkëpunimit. Qasja jonë është që të kemi biseda të sinqerta dhe të besueshme që prej fillimit e jo të bëjmë gjykimet pasi të kenë vepruar ata.

Janë disa momente që e karakterizojnë ushtrimin nga ana e ICR-së të përgjegjësive të tij: certifikimi i Kushtetutës nga ana e tij në prill 2008 që është në përputhje me dispozitat e PGJS-së; certifikimi nga ana e tij përgjatë një periudhe disa mujore të rreth 50 ligjeve të ndërlidhura me pakon e Ahtisarit dhe në përputhje me PGJS-në; miratimi nga ana e tij i vendimit të Presidentit në janar 2009 për ta lejuar vazhdimin e mandatit të Kuvendit e jo për ta pushuar atë me ç'rast do të duhej të mbaheshin zgjedhjet e reja këtë vit; si dhe fjalimi i tij në Kuvend në shkurt 2009 ku ka reflektuar për përvjetorin e parë të pavarësisë së Kosovës. Këto momente e pasqyrojnë tërësinë e veprimtarive të ICR-së, duke i përfshirë aspektet politike dhe ceremoniale.

Shtetet anëtare të Grupit Ndërkombëtar Drejtues (ISG) kanë investuar dhe vazhdojnë të investojnë resurse të konsiderueshme, si financiare ashtu edhe kapital njerëzor, për ardhmërinë e Kosovës, qoftë drejtpërsëdrejti apo edhe nëpërmjet ICO-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Veç kësaj, ISG-ja dhe ICO-ja kanë një vizion ambicioz të përbashkët për

zbatimin e shpejtë dhe të plotë të PGJS-së. Ky vizion përputhet me vetë PGJS-në, i cili kërkon rishikimin e autorizimeve dhe mandatit të ICR-së brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi së PGJS-së, me vështrim drejt “zvogëlimit të fushëveprimit të pushteteve të ICR-së dhe të shpeshtësisë së intervenimit.” Duke e ditur këtë hapësirë kohore ambicioze dhe duke qenë mirënjohës për resurset të cilat i kanë zotuar shtetet e ISG-së, ICO-ja e paraqet këtë raport për t’i njoftuar shtetet anëtare për progresin që është arritur si dhe për sfidat që i kemi përpara.

II. PËRMBUSHJA E ZOTIMEVE – PROGRESI I KOSOVËS NË ZBATIMIN E PGJS-së

Më 17 shkurt 2008, kur përfaqësuesit e popullit të Kosovës, të zgjedhur në mënyrë demokratike, e ndërmorën hapin e shpalljes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, ata u zotuan pa rezerva se do ta zbatojnë PGJS-në, duke i përfshirë këto parime në vetë Deklaratën e Pavarësisë. Duke vepruar në këtë mënyrë, ata kanë pasqyruar vullnetin e popullit të Kosovës.

“Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

Deklarata e Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Vetëm disa javë pas pavarësisë, më 1 prill, Komisioni Kushtetues i Kosovës e miratoi projekt-kushtetutën, e cila e inkorporon, ndër të tjera, obligimin e Kosovës për t’iu përmbajtur PGJS-së, si dhe autoritetin e ICR-së si interpretuesi përfundimtar i PGJS-së në sferën juridike vendore. Një ditë pas miratimit të saj nga Komisioni, ICR-ja vërtetoi se projekt teksti ishte në përputhje me dispozitat e PGJS-së dhe më 9 prill 2008 ajo u miratua nga Kuvendi i Kosovës. Kushtetuta e Kosovës hyri në fuqi më 15 qershor 2008 bashkë me 41 ligjet e dekretuara në të njëjtën ditë nga Presidenti i Republikës.

Në dhjetë muajt e parë të ekzistencës të tij si organi më i lartë ligjvënës, Kuvendi i Kosovës ka miratuar më shumë se 50 ligje që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e dispozitave të PGJS-së. Në kuadër të këtyre dispozitave ligjore janë përfshirë edhe aktet për decentralizimin e pushtetit qeverisës në komunat e Kosovës; për ndërtimin e kapaciteteve qeverisëse të Kosovës dhe për garantimin e të drejtave dhe lirive të bashkësive të Kosovës, duke përfshirë edhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore.

1. Decentralizimi

Në kuadër të ligjeve të para për zbatimin e PGJS-së ishin ato që kanë të bëjnë me procesin e decentralizimit i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme. Ligjet për Vetëqeverisjen Lokale, Kufijtë e Komunave, Financat e Pushtetit Lokal, Arsimin Lokal dhe Shëndetësinë Lokale, jo vetëm që e krijojnë kuadrin për formimin e komunave të reja në bazë të PGJS-së, por, me po kaq rëndësi,

bëjnë kodifikimin e parimit kryesor të vetë decentralizimit – që interesat e demokracisë dhe efikasitetit përmbushen më së miri duke i afruar kapacitetet qeverisëse sa më pranë qytetarëve. Në përputhje me këto ligje, janë ndarë 3.9 milion euro për shpenzimet e formimit të komunave të reja në bazë të PGJS-së; Ministria e Pushtetit Lokal ka udhëhequr një fushatë publike në tërë vendin lidhur me përfitimet e decentralizimit; ndërsa ICO-ja është duke punuar ngushtë me Grupin Punues Ndërministror të Qeverisë së Kosovës për të përcaktuar modalitetet e formimit të Ekipeve Përgatitore Komunale, të cilat do të ngarkohen me detyrën e ndërtimit të infrastrukturës qeverisëse të komunave të reja. Bartja e parë e kompetencave është bërë në janar 2009. ICO-ja ka punuar ngushtë me Qeverinë dhe me Kuvendin për të siguruar miratimin me kohë të ligjeve përkatëse dhe zbatimin e tyre.

Formimi i komunës së Mitrovicës Veriore, siç parashihet nga PGJS-ja, vazhdon të jetë sfidë e lidhur me perceptimin e përgjithshëm të procesit të decentralizimit.

2. Ndërtimi i institucioneve

- Reforma e Sektorit të Sigurisë

Një grup tjetër i ligjeve për zbatimin e PGJS-së i miratuar më herët nga Kuvendi kishte të bënte me ligjet e parapara për krijimin e institucioneve të nevojshme për ta ushtruar në tërësi sovranitetin. Ligji për Këshillin e Sigurisë të Kosovës, Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë të Kosovës, Ligji për Autoritetin e Aviacionit Civil dhe Ligji për Themelimin e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë janë vetëm disa prej tyre që janë miratuar në kuadër të reformës koherente të sektorit të sigurisë në përputhje me parimet dhe dispozitat e PGJS-së.

Ministri Fehmi Mujota u emërua Ministër i parë i Kosovës për Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK); ai ka luajtur një rol të rëndësishëm – në përputhje me pozitën e tij dhe me parimin e kontrollit civil të organeve të sigurisë – gjatë përzgjedhjes së komandantit dhe oficerëve të FSK-së. Megjithëse jo pa vështirësi, ky proces i hapi rrugë çaktivizimit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës më 20 janar 2009 dhe fillimit të trajnimit të FSK-së.

Në shtator 2008, Qeveria e Kosovës e emëroi Driton Gjonbalajn, si Drejtor të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. AACK-ja ka marrë rol prijës për të garantuar sigurinë e aviacionit civil në Kosovë dhe e ka përfaqësuar Kosovën në forumet rajonale të aviacionit civil.

Më 6 shkurt 2009, Kuvendi i Kosovës e konfirmoi Bashkim Smakajn si Drejtor të parë të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë dhe ai u ngarkua me ndërtimin e një agjencie shumetnike dhe jopolitike. Këshilli i Sigurisë i Kosovës e ka mbajtur takimin e parë të tij më 11 shkurt 2009 dhe tani janë duke u bërë angazhime për ta formuar Sekretariatit e KSK-së, i cili do t'i mundësojë këtij organi që ta luajë rolin e tij të duhur për bashkërendimin e politikave të Kosovës për sigurinë dhe mirëqenien kombëtare, pa i dyfishuar funksionet e ministrive të Qeverisë.

Në përputhje me dispozitat e PGJS-së, Republika e Kosovës është angazhuar për të bërë demarkacionin e kufirit të saj me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Të dy vendet i kanë caktuar përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Përbashkët Teknik (KPT), i cili ka mbajtur takime të shumta. Bashkërisht, KPT-ja është pajtuar lidhur me vendet e vendosjes së të gjithë gurëve kryesorë të kufirit. Në afërsi të fshatrave Debëllde dhe Tanushë, ka mbetur edhe një pjesë e vogël e kufirit për t'u demarkuar. ICO-ja është përfshirë nga afër në procesin e demarkacionit të kufirit, si në KPT ashtu edhe në kufi.

- Sundimi i ligjit

Një element i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të një sektori funksional të sundimit të ligjit ishte vendosja dhe shtrirja e misionit më të madh deri më sot të PESM-së, EULEX-it, në tërë vendin në fund të vitit 2008. Policët, gjykatësit, prokurorët dhe zyrtarët doganorë të tij do të ofrojnë një përkrahje të domosdoshme për përpjekjet e Kosovës për forcimin e sundimit të ligjit. Edhe angazhimet për themelimin e Gjykatës Kushtetuese kanë shënuar progres të rëndësishëm gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar. Ligji për Gjykatën Kushtetuese u miratua nga fundi i vitit 2008, dhe një mekanizëm i përkohshëm është formuar për regjistrimin e rasteve të mundshme për këtë gjykatë. Tani ka filluar procesi i përzgjedhjes së gjykatësve ndërkombëtarë dhe vendas. Gjykatësit ndërkombëtarë do të emërohen në bashkërendim me Presidentin dhe me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta e Kosovës e ka themeluar Këshillin e Pavarur Gjyqësor (KPGJ), si një organ i pavarur përgjegjës, mes tjerash, për të gjitha vendimet lidhur me propozimin e kandidatëve për postet në gjyqësi. Që atëherë, Kosova i ka miratuar ligjet për zbatimin e kësaj, në mënyrë që ta rregullojë edhe më tej përbërjen dhe organizimin e KPGJ-së.

Po ashtu, janë duke u bërë angazhime lidhur me procesin e përgjithshëm të rishikimit dhe të riemërimit të gjithë gjykatësve dhe prokurorëve në tërë Kosovën të paraparë me Shtojcën IV të PGJS-së dhe me Kushtetutë. Në janar, Presidenti i Republikës së Kosovës i ka emëruar të gjithë anëtarët e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP). KPGJP para ca kohe e ka nisur procesin e riemërimit për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët.

- Ekonomia

Një grup i tërë i ligjeve për zbatimin e PGJS-së i miratuar nga Kuvendi kishte të bënte me ligjet e parapara për krijimin e institucioneve të nevojshme për ta përcaktuar kornizën ligjore për ekonominë, ashtu si parashihet dhe përcaktohet nga PGJS-ja. Këtu përfshihen ligjet për ndërmarrjet në pronësi publike, për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (APK), për Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) dhe për rregullatorë të ndryshëm, të pavarur, ekonomikëtë Kosovës. Pas miratimit të ligjeve, APK-ja nisi të punojë me sukses verën e kaluar, kurse AKP-ja e ka përshpejtuar zgjidhjen e kërkesave. Gjithashtu, ICR-ja i ka bërë emërimet kryesore në fushën e ekonomisë siç parashihet me anë të PGJS-së, duke përfshirë Auditorin e Përgjithshëm të

Kosovës, një anëtar të bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) dhe anëtarët e Bordit të APK-së.

3. Të drejtat e komuniteteve dhe trashëgimia fetare e kulturore

Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe e trashëgimisë fetare dhe kulturore janë në vetë thelbin e PGJS-së dhe zënë vend qendror në Kushtetutën e Kosovës e cila përfshin të drejtat në këtë shtet shumetnik, laik dhe demokratik. Në mesin e ligjeve të para të tilla që janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës ishte Ligji për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe Ligji për krijimin e zonave të veçanta të mbrojtura. Pjesa e parë e legjislacionit siguron kornizën ligjore për të drejtat e komuniteteve që parashihen në kushtetutë, përfshirë sferën e arsimit, identitetin dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare të Kosovës. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe përfshirja e tyre në jetën publike të Kosovës adresohen gjithashtu nga Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK). KKK-ja është themeluar në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe është formuar me dekret të Presidentit të Kosovës. Këshilli ka mbajtur seancën e tij të parë në dhjetor të vitit 2008.

Ligji për krijimin e zonave të veçanta të mbrojtura krijon një mekanizëm për mbrojtjen e trashëgimisë së pasur fetare dhe kulturore të Kosovës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vendet e Kishës Ortodokse Serbe (KOS). Me këtë mbrojtje synohet që të ndalohet shfrytëzimi i tokës i cili do të ndryshonte karakterin ose dukjen e vendeve ose do të çrregullonte jetën kishtarë të klerit. Ndonëse zonat e veçanta të mbrojtura janë të dizajnuara për mbrojtjen e disa vendeve të KOS-it nga zhvillimi, autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa praktik për përkrahjen e mbrojtjes fizike të vendeve të KOS-it dhe të qëndrueshmërisë ekonomike të Kishës. Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, ka kontraktuar një kompani private të sigurisë për të siguruar mbrojtje njëzetekatër orë të vendeve të KOS-it që konsiderohen se janë më të rrezikuara. Në shkurt të vitit 2009, kjo kontratë është pezulluar dhe Policia e Kosovës ka marrë përsipër përgjegjësinë e saj për mbrojtjen njëzetekatër orë të këtyre vendeve.

Zbatimi nga Policia e Kosovës i Urdhrit Operativ për mbrojtjen e vendeve të shenjta të KOS-it do t'ua mundësojë partnerëve ndërkombëtarë, siç është KFOR-i, që të vazhdojnë me planet për tërheqje nga detyra të tilla, pa i vënë në rrezik shtesë këto kisha dhe manastire. Zbatimi i Urdhrit Operativ po bëhet në bashkëpunim të ngushtë me ICO-në. Sa i përket qëndrueshmërisë ekonomike të KOS-it, Kodi Doganor i Kosovës i miratuar në fund të vitit 2008, ka përfshirë dispozitat që ndërlidhen me PGJS-në me të cilat lirohet KOS-i nga pagesa e disa taksave të caktuara doganore. Lirime të ngjashme do të duhet të miratohen për të implementuar dispozita të tjera të PGJS-së që ndërlidhen me vetë-qëndrueshmërinë e KOS-it.

Ka qenë sfidë për Qeverinë e Kosovës që t'i adresojë në mënyrë adekuate nevojat e komunitetit serb të Kosovës për shkak të mungesës së dialogut ndërmjet komunitetit shumicë dhe komunitetit serb të Kosovës. ICR-ja, në rend të parë në cilësinë e EUSR-së, po e drejton një

tryezë të rrumbullakët ndërmjet ministrave kyç të qeverisë dhe përfaqësuesve të serbëve të Kosovës. Qëllimi i saj është që të diskutohet implementimi efektiv i PGJS-së duke marrë parasysh nevojat e komunitetit serb të Kosovës.

Për një përshkrim të plotë të progresit të bërë deri më tani në implementim e PGJS-së, luteni t'i referoheni versionit më fundit të Matricës për Implementimin e PGJS-së të përgatitur nga ICO-ja.

III. RRJETI NË ZGJERIM I MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

17 shkurti 2008 ka shënuar deklaratën e pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht hyrjen e saj në familjen e shteteve të pavarura dhe sovraane; në vitin që pasoi është vënë re konsolidimi i shtetësisë së Kosovës përmes krijimit të rrjetit në zgjerim të marrëdhënieve ndërkombëtare nga ana udhëheqjes së saj së bashku me partnerët e ndërkombëtar.

Që nga shpallja e pavarësisë, 55 shtete e kanë njohur zyrtarisht shtetësinë e Kosovës, përfshirë 22 nga 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe nga shtete të të gjitha kontinenteve. Po ashtu, Kosovën e kanë njohur tri nga katër shtet me të cilat i ndanë kufijtë e përbashkët. Kosova i ka pajisur qytetarët e saj me dokumente të identitetit përfshirë këtu edhe pasaportat. Këto pasaporta janë njohur nga shtetet tjera si të vlefshme për udhëtim.

Në mars të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës. Skënder Hyseni është emëruar si Ministër i Jashtëm i parë i Kosovës dhe është ngarkuar me ngritjen e ministrisë së tij dhe me përfaqësimin diplomatik jashtë vendit. Në të dy drejtimet po bëhen përpjekje të lavdërueshme. Legjislacioni fillestar është pasuar nga Ligji për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe nga Ligji për Shërbimin Konsullor në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës. Këto ligje kanë siguruar bazën ligjore për krijimin e pranive diplomatike dhe konsullore jashtë vendit. Misionet e para të Kosovës jashtë vendit, të udhëhequra nga dhjetë të ngarkuar me punë, janë lajmëruar në gusht të vitit 2008. ICO-ja e ka përkrahur ngritjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme duke e themeluar Grupin Punues për Marrëdhënie të Jashtme, i cili përbëhet nga zyrtarë të Ministrisë dhe përfaqësues të ISG-së.

Qeveria e Kosovës ka pritur shumë delegacione diplomatike, përfshirë disa shefa të shteteve dhe qeverive dhe shumë ministra, përfshirë ministra të punëve të jashtme. Po ashtu, Kryeministri i Kosovës, Ministri i Jashtëm dhe ministra të tjerë janë ftuar jashtë vendit me qëllim të rritjes së bashkëpunimit.

Në korrik të vitit 2008, Republika e Kosovës ka dorëzuar kërkesën zyrtare për t'u anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Këto kërkesa kanë përkrahjen e plotë të

ICO-së dhe ICR-ja ka lobuar për pranimin nga ana e tyre. Është formuar komisioni për anëtarësim i FMN-së dhe është gati për t'ia filluar punës.

IV. VITI VIJUES

Kosova dhe ICO-ja tanimë kanë hyrë në vitin e tyre të dytë. Partneriteti i ICO-së me Qeverinë e Kosovës mbetet i fuqishëm. Megjithatë, do të ishte e papërgjegjshme që të pretendohet se progresi i arritur deri më tani siguron një përmbyllje të suksesshme. Mbetet shumë punë për të ardhmen, posaçërisht në monitorimin e zbatimit të Ligjeve që dalin nga PGJS-ja.

Prioritetet tona strategjike për muajt në vijim janë që të:

- ndihmojmë për të siguruar përfundimin e suksesshëm të reformës së sektorit të sigurisë;
- mbajmë përqendrimin tonë në decentralizim;
- ndihmojmë në forcimin e sundimit të ligjit, në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in;
- kushtojmë vëmendje qeverisjes së mirë dhe reformës ekonomike.

Nga të gjithë sektorët, ata që përfshijnë sigurinë dhe rendin publik kanë shënuar progresin institucional më të madh gjatë muajve të fundit. Të gjitha institucionet e sigurisë që parashihen në Aneksin VIII të PGJS-së dhe në Kapitullin XI të Kushtetutës po përparojnë. Por, disa nga to nuk kanë përvojë në praktikë dhe nuk janë të plotësuar me personel. Nevoja për resurse do të vazhdojë të jetë e pranishme. ICO-ja dhe bashkësia ndërkombëtare do të duhet të ofrojnë përkrahje të vazhdueshme për të siguruar zhvillimin institucioneve të reja, meqë ato kanë rol kyç në shoqëri.

Njësoj si në vitin 2008, ICO-ja do të vazhdojë punën e saj me Qeverinë e Kosovës për të avancuar procesin e decentralizimit, si në krijimin e pesë plus një komunave që parashihen në PGJS, ashtu edhe në bartjen e kompetencave të gjitha qeveritë lokale të Kosovës. Procesi i suksesshëm i decentralizimit, i cili do t'ua mundësojë të gjitha komuniteteve që të vendosin për punët e tyre në nivelin lokal dhe komunal, do të jetë elementi kyç për një pajtim të qëndrueshëm në Kosovë.

Janë të nevojshme përpjekje shtesë për të forcuar qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. ICO-ja do të vazhdojë të punojë ngushtë me misionin e EULEX-it me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë. Sfidat shtrihen nga mundësimi i veprimit të Doganës në mbarë territorin; gjykatat efikase, të drejta dhe të afta; si dhe një polici e aftë shumetnike në mbarë territorin e Kosovës.

Në fund, reforma e përshpejtuar e ekonomisë duhet të përfshijë disa elemente, ku të gjitha nga to kanë të bëjnë me përgjegjësitë që dalin nga PGJS-ja. ICO-ja do të vazhdojë të inkurajojë përgjegjësinë fiskale nga ana e Qeverisë së Kosovës, kryesisht duke forcuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e buxhetit, përmes konsultimeve buxhetore që janë të mandatuara nga PGJS-ja. Po ashtu, ICO-ja do t'i inkurajojë partnerët e saj të Kosovës që të mbajnë zotimin e tyre për ta përfunduar shpejtë privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore si dhe vlerësimin e kërkesave të kreditorëve dhe të pronësisë mbi to, nëpërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Gjithashtu, Kosova duhet të fillojë me privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha publike në mënyrë transparente, si dhe të përmirësojë standardet e udhëheqjes së të gjitha ndërmarrjeve publike, me vështirësi drejt privatizimit të tyre eventual. ICO-ja do të punojë ngushtë me autoritetet e Kosovës për të nxitur një proces transparent dhe objektiv të përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të bordeve dhe të posteve të tjera kyçe, ashtu siç parashihet në PGJS. ICR-ja gjithashtu do të përkrahë reformën në sektorin e energjetikës me qëllim që të ndihmojë në krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Përmes përpjekjeve dhe vigjilencës së vazhdueshme, besojmë se viti 2009 do të jetë vit i progresit për Kosovën – i progresit në plotësimin e përkushtimeve të saj drejt vetes dhe drejt partnerëve ndërkombëtar për implementimin e PGJS-së dhe përparimin drejt të ardhmes që parashihet në Kushtetutën e saj, “si vend i lirë, demokratik dhe paqedashës që do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të saj”.